



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTARI REGJISTRIMIT
TË TRASHËGIMISË KULTURORE
Nr. 105 Prot.
Tiranë, më 19.2.2021

MINISTRI

Nr. 316 prot

Tiranë, më 17.2.2021

U R D H Ë R

Nr. 15, datë 17.2.2021

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË REGJISTRIMIT TË
TRASHËGIMISË KULTURORE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 dhe nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimin nr. 432, datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 136, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Statutit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, për zbatimin e këtij Urdhri, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë për Kulturën në Ministrinë e Kulturës për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva Margariti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

**STATUTI I INSTITUTIT KOMBËTAR TË REGJISTRIMIT TË
TRASHËGIMISË KULTURORE
IKRTK**

MIRATOI

MINISTËR

Elva Margariti



Tabela e Përbajtjes

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	3
Neni 1 Objekti.....	3
Neni 2 Statusi juridik.....	3
Neni 3 Misioni.....	3
Neni 4 Parimet.....	4
Neni 5 Stema, Vula zyrtare dhe logo.....	4
Neni 6 Selia.....	4
KREU II ORGANIZIMI FUNKSIONIMI I IKRTK-së.....	5
Neni 7 Organizimi dhe Funksionimi.....	5
Neni 8 Struktura organizative.....	5
Neni 9 Detyrat e IKRTK-së.....	5
KREU III DREJTIMI, DETYRAT E DREJTORIT DHE MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT	
Neni 10 Detyrat e drejtorit.....	8
Neni 11 Punësimi.....	9
KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR.....	10
Neni 12 Të ardhurat buxhetore.....	10
Neni 13 Hartimi i projekt buxhetit.....	10
Neni 14 Auditimi financiar.....	10
KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE.....	10
Neni 15 Propozimi dhe ndryshimi në statut.....	10
Neni 16 Hyrja në fuqi.....	11

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Ky statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, në vijim IKRTK.

Neni 2 Statusi juridik

1. IKRTK, krijohet, organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” vendimin vendimin e nr. 432 datë 26.06.2019 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë se Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, urdhri i Kryeministrit nr. nr. 136 datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit Kombëtar te Regjistrimit te Trashëgimisë Kulturore”, rregulloren e brendshme të IKRTK-së, si dhe me dispozitat e këtij statuti.
2. IKRTK është institucion kombëtar i specializuar shkencor, me organizim në nivel qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i pavarur nga subjektet politike dhe grupet e tjera të interesit.

Neni 3 Misioni

1. IKRTK-ja ka për mision krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar.
2. IKRTK-ja, në funksion të përbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, organet e policisë, institucionet doganore si dhe institucionet ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore.
3. IKRTK në veprimtarinë e saj zbaton strategjinë e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.
4. IKRTK propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e trashëgimisë kulturore e të investimeve private në këtë fushë.
5. Veprimitaria e IKRTK konsiston në:
 - a. krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar. IKRTK-ja, në funksion të përbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, organet e policisë, institucionet doganore si dhe institucionet ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore.
 - b) regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare) monitorimin dhe koordinimin e punës me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore.

Neni 4
Parimet

1. IKRTK-ja, në veprimtarinë e saj, mbështet dhe përkrah lirinë e informacionit dhe të informimit si një e drejtë themelore e qytetarëve dhe siguron qasje të barabartë për të gjithë.
2. IKRTK-ja gjithashtu, ushtron veprimtarinë e saj në respektim të parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë, mosdiskriminimit, parimin e mbrojtjes së të dhënave, ruajtjes së konfidencialitetit, deburokratizimit, eficencës, ekonomicitetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve dhe profesionalizmit.

Neni 5
Stema, Vula zyrtare dhe logo

1. IKRTK-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare.
2. Stema e IKRTK-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet institucionit “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS, INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË”
3. IKRTK administron vulat e tij zyrtare. Vula e IKRTK-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, si vijon:
 - a) Vula e IKRTK-së, me formë rrethore ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS, INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË” dhe stema e Republikës së Shqipërisë;
 - b) Vula e protokoll/arkivës, me formë drejtkëndore ku në rreshtin e parë përcaktohet emërtesa e institucionit “INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË”, në rreshtin e dytë përcaktohet “Nr. ____ Prot.” dhe në rreshtin e tretë përcaktohet “Tiranë, më ____ . ____ .20 ____ ”;
 - c) Vula e sekretarisë, me formë rrethore ku përcaktohet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË, SEKRETARIA, TIRANË” dhe stema e Republikës së Shqipërisë.
 - d) Vula e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, me formë katrore ku përcaktohet në rreshtin e parë “Ministria e Kulturës, në rreshtin e dytë Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, në rreshtin e tretë “Baza e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore” dhe në rreshtin e katërt “KODI RKPK _____ dhe në rreshtin e pestë KODI I POSEDUESIT _____ ”

Neni 6
Selia

IKRTK është person juridik publik në varësi të ministrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me selinë në Tiranë me adresë: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”.

KREU II **ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI I IKRTK-së**

Neni 7 **Organizimi dhe funksionimi**

1. IKRTK-ja e shtrin veprimtarinë e saj për trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:
 - a) nivel qendror të regjistrimit të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
 - b) nivel rajonal, nëpërmjet zyrave rajonale të IKRTK-së dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, të cilat funksionojnë pranë DRTK-ve.
2. IKRTK-ja menaxhon aktivitetin e zyrave rajonale dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, sipas parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve.
3. Pranë IKRTK-së funksionon Komisioni Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore në pasuritë e luajtshme.

Neni 8 **Struktura organizative**

1. IKRTK organizohet dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 136 datë 21.10.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit Kombetar te Regjistrimit te Trashëgimisë Kulturore*”.
2. Numri i punonjësve, Struktura dhe Organika propozohet nga Drejtori i dhe përcillet në organin epror, i cili vazhdon procedurën e mëtejshme të shqyrtimit dhe dërgimit për miratim në institucionet kompetente.
3. IKRTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKRTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 9 **Detyrat e IKRTK-së**

1. IKRTK-ja, në ushtrimin e veprimtarisë së saj ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në:
 - i. regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin e promovimin e trashëgimisë kulturore;
 - ii. monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - iii. ofrimin e shërbimeve organeve të administratës shtetërore qendrore, të pushtetit vendor, të institacioneve shkencore, kulturore apo fetare, të personave fizikë e juridikë privat për evidentimin, regjistrimin dhe katalogimin e pasurive kulturore;

- iv. dokumentimin sipas kritereve shkencore të trashëgimisë kulturore, të mbikëqyrë e të monitorojë respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, studimin, botimin dhe promovimin, ruajtjen e administrimin e database-it kombëtar të pasurive kulturore dhe të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e pasurive kulturore në nivel kombëtar;
- b) Regjistrin e dokumenton të gjitha pasuritë kulturore, materiale dhe jomateriale, si dhe pasuritë e peizazhit në pronësi publike e private në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) Regjistrin në kartelat e pasurive kulturore vendimet e këshillave kolegjalë të trashëgimisë kulturore; Regjistrin transferimet e pasurive kulturore ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore ose të institucioneve të tjera publike vendore;
- ç) Regjistrin lejet për ndërhyrjet ruajtëse të miratuara nga KKTKM-ja;
- d) Regjistrin masat e mbrojtjes indirekte në regjistrat e pasurive;
- dh) Regjistrin objektet muzeore, koleksionet, si dhe lidhjen ose jo të objekteve muzeore me koleksionet, që janë pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore;
- e) Harton platformën për regjistrimin e të gjitha pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme, që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, personat privat, institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe bashkësítë fetare të regjistruar me ligj, për krijimin dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore;
- ë) Harton dhe mban regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme;
- f) Harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin e qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore me propozim të përbashkët me IKTK-në;
- g) Administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatik kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale;
- gj) Administron katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar;
- h) Administron bazën shtetërore të të dhënave të pasurive kulturore;
- i) Administron bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;
- j) Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore përfunksionet që IKRTK-ja ka kompetencë;
- k) Administron e përditëson Regjistrin Kombëtar të Pasurive Jomateriale dhe të Pasurive Materiale, në përpjekje me seksionet përkatëse të pasurive kulturore të paluajtshme, si dhe të pasurive kulturore të luajtshme e të koleksioneve;
- l) Administron një Regjistër Kombëtar të Licencave të Eksportit të Pasurive Kulturore;
- ll) Administron Regjistrin e Tregtimit të Pasurive Kulturore;
- m) Administron një kopje të dokumentacionit të marrjes në dorëzim të punimeve të ndërhyrjeve në pasuritë e paluajtshme;
- n) Administron një kopje të listës së lejeve të ndërhyrjeve në pasuritë e peizazhit;

- nj) Lëshon certifikata regjistrimi të pasurive kulturore, të luajtshme e të paluajtshme dhe, në rast të humbjes së saj, lëshon një dublikatë;
- o) Lëshon dokumentacionin për ekzistencën e objekteve muzeore në muze, për krijimin dhe regjistrimin e muzeve ekzistues e të rinj;
- p) Lëshon vërtetim për kopjet e autorizuara të çdo objekti muzeor;
- q) Mbikëqyr e monitoron respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare;
- r) Mbikëqyr zbatimin apo shkeljen e procedurave (regjimit) të qarkullimit kombëtar dhe ndërkombeitar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme;
- rr) Asiston dhe denoncon pranë inspektoratit përgjegjës për trashëgiminë kulturore; Zhvillon metodologjinë për dokumentimin e katalogimin e pasurive kulturore, si dhe koordinon bashkëpunimin me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore;
- s) Kryen regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe të çdo procedure për identifikim e regjistrim;
- sh) Monitoron procedurat e eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombeitar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit. Parashikon masat e nevojshme, me qëllim që pasuritë të mos pësojnë dëmtime gjatë transportit në rastin kur mbajtësi i pasurive kulturore ndryshon vendbanimin ose selinë, ndryshim, i cili deklarohet paraprakisht në drejtorinë rajonale të trashëgimisë kulturore përkatëse;
- th) I propozon ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mundësinë e parablerjes së pasurive kulturore;
- u) Koordinon procesin e pasqyrimit të të dhënavës në regjistrat e tjerë publikë për pasuritë e trashëgimisë kulturore të deklaruara;
- v) Miraton çdo vit listën e çmimeve të referencës për pasuritë kulturore;
- x) I jep mendim Këshillit Kombëtar të Muzeve për përcaktimin e vlerës maksimale të transaksionit për pasurimin e fondit muzeor;
- xh) Ndjek dhe Monitoron procedurat e lidhura me Licencimin e Tregtarëve të Pasurive Kulturore.
- z) Çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

2. Zyrat Rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme kanë për detyrë:

- a) Regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe çdo procedure për identifikim dhe regjistrim;
- b) Zbatimin dhe monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombeitar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit

KREU III
DREJTIMI, DETYRAT E DREJTORIT DHE MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Neni 10
Detyrat e Drejtorit

1. IKRTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKRTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Drejtori organizon veprimtarinë administrative e shkencore të IKRTK-së.
3. Drejtori i IKRTK-së emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për Trashëgiminë kulturore, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institacioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".
4. Drejtori i IKRTK-së është punonjës i nivelit të lartë drejtues, përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në institucion. Koordinon punën vertikalish me strukturat që ka në varësi.
5. Drejtori i IKRTK-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon
 - a) analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - b) është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike në përputhje me objektivat dhe misionin e IKRTK-së;
 - c) monitoron dhe kontrollon faktorët e riskut që venë në rrezik arritjen e objektivave të IKRTK-së;
 - d) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
 - e) shpérndan punën brenda institucionit dhe siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuar;
 - f) nxjerr vendimin për verifikimin e interesit kulturor në bazë të vendimit të Komisionit Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore për Pasuritë e Luajtshme.
 - g) shpall në "mbrojtje paraprake" pasuritë kulturore të luajtshme, të cilat, pas verifikimit, janë identifikuar si pasuri me vlera kulturore
 - h) shqyrton ankimin ndaj vendimit të zyrës për çështjet e eksportit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës së qarkullit të lirë ose të përkohshëm. Ndaj vendimit të titullarit të IKRTK-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.
 - i) akordon licencat e ekportit/importit në bazë të vendimit të zyrës për çështjet e eksportit në mbështetje me parashikimet e Ligjit nr.27/2018 dhe të klasifikuara në dy kategori:
 - i. Licenca eksporti të pasurive kulturore për qarkullimin e lire të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera me afat 3-vjeçar
 - ii. licenca për qarkullimin e përkohshëm të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera me afat të përcaktuar jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.
 - j) emëron dhe shkarkon punonjësit e IKRTK-së, në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme të IKRTK-së;

- k) ndjek rregullisht proceset administrative dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve;
- l) siguron/garanton që burimet në dispozicion të Institucionit të organizohen në mënyrë që objektivat e saj të realizohen me efektshmëri të lartë, në mënyrë tërësisht të rregullt dhe korrekte;
- m) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;
- n) përgjigjet për zgjidhjet ligjërisht të bazuara dhe teknike të problemeve brenda Institucionit, duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat që e konsideron të nevojshme;
- o) siguron disiplinën në strukturën që drejton dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda kompetencave ligjore, merr masa për çdo punonjës që theyn rregullat në administratën publike;
- p) drejton punën me sektorët lidhur me botimet vjetore, ribotime të tjera, albume e guida.
- q) realizon detyrat e ngarkuara nga ligji, brenda afatit dhe raporton mbi to.

Neni 11 Punësimi

1. Punësimin në IKRTK bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. IKRTK vendos marrëdhëniet e punës me punonjësit përmes kontratave me afat të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar, sipas nevojave administrative institucionale.
3. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, shkeljet dhe masat disiplinore, etj., përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të IKRTK-së.
4. Afatet dhe procedurat e njoftimit referuar përcaktimeve të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurave Administrative, për çdo rast dhe natyrë të shkeljeve disiplinore, janë si më poshtë:
 - a) Njoftimi për ecurinë disiplinore dhe zhvillimit të seancës dëgjimore i drejtohet me shkrim punonjësit të paktën 72 orë përpara datës së caktuar për takim. Njoftimi drejtohet ne vendin e punës ose në adresën e vendbanimit;
 - b) Seanca dëgjimore realizohet në prani të Drejtorit, përfaqësues nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.
 - c) Gjatë seancës dëgjimore Drejtori i parashtron punonjësit arsyet e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore konkrete dhe të vërtetuar dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur.
 - ç) Vendimi për dhënien e masës disiplinore njoftohet me shkrim brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit.

KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 12 Të ardhurat buxhetore

1. IKRTK është një institucion buxhetor shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës.
2. IKRTK në kuadër të realizimit të projekteve për trashëgiminë kulturore, mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo edhe të huaja në kuptim të Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar.

3. Fondi për buxhetin e IKRTK-së miratohet nga Ministri i Kulturës, menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.
4. Fondet vjetore të akorduara nga buxheti i shtetit dhe çdo e ardhur e realizuar nga sponsorizimet, donacionet etj, do t'i nënshtrohen rregullave të legjislacionit për prokurimin publik.
5. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga IKRTK-ja sipas legjislacionit në fuqi, VKM nr. 432 datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Financave.

Neni 14
Hartimi i projekt buxhetit

IKRTK, dy herë gjatë vitit kalendarik, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore projekt buxhetin afatmesëm, të shpenzimeve dhe të investimeve për vitin e pasardhës, të shoqëruar me preventivat përkatëse.

Neni 15
Auditimi financiar

Administrimi dhe veprimtaria financiare e IKRTK-së auditohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Propozimi dhe ndryshimet në statut

1. Statuti i IKRTK-së, propozohet nga Drejtori dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Ky statut përmirësohet sa herë që praktika e punës dhe ndryshimet në legjislacion e bëjnë të nevojshme një gjë të tillë. Ndryshimet në statut propozohen nga Drejtori dhe miratimi bëhet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet statuti i miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës, Nr. 9, datë. 28.8.2008.